



THE GOVERNMENT
OF THE GRAND DUCHY OF LUXEMBOURG



Thirrje për aplikim

Përmes skemës së mbështetjes nga Luksemburgu për shoqërinë civile në Kosovë (Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut), BIRN Kosova mirëpret aplikimet për pranim në trajnimet mbi "Përmirësimi i Standardeve të Gazetarisë Hulumtuese përmes Përvojave të Përbashkëta". Afati i fundit për aplikim është **4 qershor, 2018 në orën 17:00**. BIRN Kosova po mundëson trajnime për studentët e gazetarisë, juridikut dhe gazetarëve të rinj, mbi etikën e gazetarisë dhe pasojat ligjore të raportimit të pasaktë.

Për aplikim, ju lutemi të dërgoni materialet në vijim:

- a. Formularin e aplikimit (bashkëngjitur në thirrje)
- b. Letër motivuese 250 fjalë (bashkëngjitur në formën e aplikimit)

BIRN Kosova do të mbajë shtatë (7) trajnime në përgjithësi në komuna dhe në vende të ndryshme të Kosovës. Duke pasur parasysh që trajnimi do të përmbajë module të njëjta, aplikuesi mund të zgjedhë vendndodhjen e dëshiruar duke e cekur atë në aplikim. Në rast të plotësimit të vendit, BIRN Kosova do t'ju zhvendosë në një grup tjetër.

Edhe pse e preferuar, nuk është e detyrueshme që aplikuesi të jetë student i gazetarisë. Çdokush që studion gazetari, apo është i interesuar të ndjekë karrierë në gazetari, i përmbush kriteret e aplikimit.

Kliko këtu për të aplikuar: <https://goo.gl/forms/LdYyf7O7KPOyQwJ73>

Objektivat dhe modulet e trajnimit

Duke marrë parasysh që trajnimet në gazetari janë themelore për rritjen e standardeve të kësaj fushe, BIRN Kosova përmes Fondacionit për Shoqërinë Civile Kosovare (KCSF) dhe me mbështetjen e qeverisë së Luksemburgut, është e dedikuar të angazhojë ekipin e saj të gazetarëve, këshilltarëve ligjorë, hulumtuesit dhe mbikëqyrësit për të ofruar këto trajnime.

Modulet e këtij trajnimi janë:

- Hyrja në profesionin e gazetarit dhe respektimi i standardeve të etikës në gazetari;
- Edukimi për pasojat ligjore nga Ligji i shpifjes dhe fyerjes për raportimin e pasaktë, shkeljet e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Pasojat ligjore penale për gazetarët në rastet kur keqraportohet. Edukimi dhe pasojat etike dhe të rregullatorëve të pavarur për raportimet e pasakta.
- Raportimi i drejtë dhe i saktë nga gjykata dhe raportimi në situata krizash si rastet në terrorizëm, ekstremizëm të dhunshëm, abuzim të fëmijëve, vërshimeve, katastrofave natyrore apo raportimit pas incidenteve kriminale.
- Raportimi duke përdorur mediat sociale, përdorimi i tyre për të hulumtuar dhe mundësitë e pikëtimit të lajmeve të rreme/të pasakta në rrjetet sociale;
- Raportimi përmes analizuesit të fakteve (Krypometër);
- Hulumtimi i thellë në dokumente publike dhe edukimi për rrugët ligjore për qasje në dokumente publike;
- Përdorimi i kallxuesve, platformave për raportim të korrupsionit dhe informacioneve nga qytetarët për të hulumtuar raste të mëdha të korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Ju lutemi dërgoni pyetjet tuaja lidhur me procesin e aplikimit në e-mail: deniza.mulaj@birn.eu.com deri më datën 1 qershor 2018.

Ky dokument është hartuar për qëllime të projektit 'Përkrahja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë', financuar nga Dukati i Madh i Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).